



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MAT
NJËSIA E PROKURIMIT

Burrel, më _____.____.2023

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT “SHËRBIM KONSULENCE”

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Hartim i Planit të Mbarështrimit për ekonominë pyjore “Derjan 1”, Mbasdejë”,

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

77231000-8 Shërbimet për menaxhimin e pyjeve.

VLERA E FONDIT LIMIT:

4 228 333.33 (katër milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e treqind e tridhjetë e tre pikë tridhjetë e tre) **lekë pa TVSH nga granditë e bashkisë.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c, dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti/ enti kontraktor **Bashkia Mat** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2. Kandidati/ Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 11).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2020, 2021, dhe 2022**, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit të kontratës që prokurohet.
- 2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2020, 2021, dhe 2022**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të *ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009*, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.
- 2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2023** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, *ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 12 të DST-së.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/b dhe 3** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **b) gjendjen ekonomike dhe financiare;**... 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. **Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.**”

Në **nenin 43** “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare..”

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c) **40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.**

3. **Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.**

4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. **Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

Ndërsa në **nenin 54 “Shërbim konsulence” pika 9/3** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”** (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“Në rastin e bashkimit të konsulentëve secili prej tyre duhet të plotësojë kriteret detyruese për kualifikim sipas nenit 76, të LPP-së, ndërkohë kërkesat për kualifikim sipas përcaktimit në nenin 77, të LPP-së, dhe këto rregulla plotësohen bashkërisht nga i gjithë bashkimi.”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Referuar ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) neni 29 i tij, ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) pika 3.12 e tij, autoriteti kontraktor gjykon që të kërkojë xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, dhe 2022 lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më pak se 40 % e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2020, 2021, 2022) të konfirmuar nga administrata tatimore, pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin që të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij me kushtin që në dy bilance të njëpasnjëshme të mos kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim të konsulentëve, në zbatim të pikës 9/3 të nenit 54 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, këto kërkesa përmbushen nga i gjithë bashkimi.

Po ashtu, njësia e prokurimit gjykon se, bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal,

në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vëndet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rast se në faturat tatimore shitje nuk përfshihen të gjitha zërat e shërbimeve, ato duhet të shoqërohen me situacionet ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/c dhe 4** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) **Aftësinë teknike dhe profesionale**;... 4. **Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.**”

Në **nenin 41** “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” **pika 3** dhe **6** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.”

6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i kësaj norme juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t’u vendosur ne DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kriteret janë kritere detyrues, dhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme.

Njësia përcaktoj kriteret për shërbime të ngjashme si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Sipas këtij neni, Njësia vlerëson se krahas dokumentacionit ligjor të kërkuar sipas parashikimit të pikës 3 të nenit 41 të VKM-së, referuar rëndësisë që ka shërbimi objekt prokurimi, me qëllim vërtetimin e përvojës së mëparshme në kryerjen e shërbimeve të ngjashme të operatorëve ekonomik, njësia e prokurimit vlerëson se në rast se në faturat tatimore shitje nuk përfshihen të gjitha zërat e shërbimeve, atëherë duhet kërkuar dhe dokumentacioni ligjor shtesë si, situacioni i kryerjes së shërbimit i cili përmban të dhënat e shërbimeve të realizuara, gjë e cila nuk sjell kosto shtesë për operatorët ekonomik (*disponohet si dokument nga ana e tyre*), dhe ndihmon në vlerësimin e drejtë të përmbushjes së qëllimit që ka ky kusht ligjor.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me licencën e nevojshme profesionale për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, për përmbushjen e të cilit duhet të paraqesë licencën – **Kodi III.7.A** – “Shërbime të ekspertizës dhe/ ose profesionale lidhur me pyjet apo kullotat” lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB).

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin **77 pika 1, 2** dhe **4** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë

kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;**... 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

Në **nenin 41** “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” **pika 4/a** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se, referuar natyrës së shërbimit objekt prokurimi, ai i hartimit të planit të mbarështrimit, bazuar në parashikimet e **nenit 68** “Licencimi i veprimtarive me ndikim në mjedis” të ligjit nr. **10 431, datë 09.06.2011** “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, në të cilin përcaktohet se, citojmë: “Veprimtaritë me ndikim në mjedis, të përcaktuara në këtë ligj, licencohen sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe përfshihen në fushën III të shtojcës së tij.” Shtojcës së ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” në të cilin përcaktohet se, citojmë: “**Fusha III. Mjedisi dhe burime mjedisore bazë. 18.7 Licencë Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet mjedisore bazë**”, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” në të cilin përcaktohet se, citojmë: “1. Veprimtaria e “shërbimeve të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me burimet mjedisore bazë” është kategoria III.7 e Shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë. 2. Kategoria e kësaj veprimtarie specifikohet në dy nënkategori si vijon: a) “shërbime të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me pyjet apo kullotat”, me kodin III.7.A.”, njësia e prokurimit vlerëson se **operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë licencën profesionale për ushtrimin e veprimtarisë objekt prokurimi, si dhe nënkategorinë e kërkuar (III.7.A) të përcaktuar në përputhje me natyrën e shërbimit objekt prokurimi, atë të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me pyjet apo kullotat.** Në lidhje me përmbushjen e këtij kushti, njësia e prokurimit ka kërkuar dokumentacionin në mbështetje të ligjit nr.10 081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” për vërtetimin se op. ek. pjesëmarrës disponon licencën e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit objekt prokurimi.

Njësia e prokurimit përcaktoj kërkesën si më lart, duke qënë se është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës, por edhe sepse mbi të gjitha i shërben autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre (*besueshmërinë*) për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë jo më pak se **3 (tre) punonjës** si staf kryesor që do të angazhojë në realizimin e këtij shërbimi (e barazvlefshëm me stafin minimal, që konsulenti duhet të angazhojë në këtë shërbim) për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

2.3.4 **Operatori ekonomik pjesëmarrës, me qëllim realizimin e shërbimeve objekt kontrate, referuar kompleksitetit në kryerjen e këtij shërbimi, rëndësisë dhe përvojës profesionale duhet të disponojë stafin kryesor teknik me kualifikimet dhe çertifikimet profesionale, si më poshtë:**

- Minimumi **1 (një) Inxhinier Pyjesh**, i cili do të jetë dhe drejtues i grupit (stafit teknik) të punës, i cili duhet të jetë i pajisur me çertifikatë profesionale për projekttime e zbatime me përvojë në fushën e pyjeve dhe kullotave, Hartimin e Planeve të Mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, menaxhimin e tyre të qëndrueshëm, aspekteve silvo-pastorale, të mbrojtjes dhe zhvillimit të burimeve natyrore, të ketë aftësi të mira organizative në grup etj., të përdorë mirë teknologjinë në marrjen e të dhënave të terrenit dhe regjistrimin online të tyre, sipas programeve të miratuara.
- Minimumi **1 (një) Inxhinier** ose **Teknik Pyjesh**, i cili duhet të jetë me përvojë në punimet e terrenit për Hartimin e Planeve të Mbarështimit dhe që njeh mirë territorin në studim.
- Minimumi **1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder**, i cili duhet të jetë i pajisur me licencë në fushën e projekttimeve nga organet kompetente, dhe të ketë njohuri e të përdorë programet GIS, ndarjen e ngastrave e n/ngastrave, përgaditjen e hartave të ndryshme sipas termave të referencës (dixhitalizimin, gjeoreferimin etj.), përpunimin dhe menaxhimin e të dhënave dixhitale. jetë me përvojë në punimet e terrenit për Hartimin e Planeve të Mbarështimit dhe që njeh mirë territorin në studim.

Eksperiencat e punës dhe profilet e stafit teknik/ekspertëve kryesorë që do të angazhojë në kryerjen e këtij studimi, do të duhet të vërtetohen nga ana e kontraktorit me, kontratat individuale të punës (*e vlefshme gjatë kohës së hartimit të planit*), diplomë, Librezë pune, CV-të, çertifikata kualifikimi, studime dhe/ose rekomandime.

2.3.5 Për stafin kryesor të angazhuar, operatori duhet të paraqesë deklaratë disponueshmërie për secilin prej tyre, për kryerjen e shërbimit që ka marrë përsipër të realizojë.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** pika **1** dhe **4** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. **4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”**

Në **nenin 41** “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” **pika 4/b** dhe **c** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “**4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:...**

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kriteret janë të detyrueshme për t’u vendosur në DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kriteret janë kriteret detyrues edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërm.

1. Kriteri i vendosur për disponimin e numërit minimal prej **3 (tre) punonjës**, duke përfshirë dhe stafin teknik, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së, dhe nenit 41 pika 4/c të VKM-së, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përllogaritjen e numrit të punonjësve, autoriteti kontraktor ka marrë parasysh numrin e stafit teknik të inxhinierëve që nevojitet për realizimin e shërbimit sipas kushteve të parashikuara në

Shtojcën 10 “*Termt e Referencës*” dhe llojit të studimit që do të kryhet, për të cilat kërkohet shërbimi objekt prokurimi, ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “*Për tatimin mbi të ardhurat*” (i ndryshuar), Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “*Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike*” si dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “*Për tatimin mbi të ardhurat*” (i ndryshuar), njësia e prokurimit ka përcaktuar dokumentat konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës për përmbushjen e këtyre kushteve, dokumenta të cilat nuk përbëjnë kosto shtesë për plotësimin e dokumentacionit nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës. Ndërsa në lidhje me periudhën e kërkuar, për të paktën 3 muajt e fundit, njësia e prokurimit në hartimin e këtij kriteri iu është referuar datës së publikimit dhe zhvillimit të kësaj procedure prokurimi, **ku ka vlerësuar të nevojshme që për vërtetimin e bindjes se operatori ekonomik pjesëmarrës ka një qëndrueshmëri dhe besueshmëri në fuqinë punëtore që realisht disponon**, ka kërkuar që ky punësim të disponohet deri në 3 (tre) muaj përpara zhvillimit të procedurës së prokurimit, kërkesë e cila është e arsyeshme, proporcionale dhe aspak diskriminuese.

2. Me qëllim kryerjen e shërbimit objekt prokurimi, bazuar në *Manualin e Planeve të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit*, dhe *Termave të Referencës të shërbimit*, referuar kompleksitetit në kryerjen e këtij shërbimi, rëndësisë dhe përvojës profesionale duhet të disponojë stafin kryesor teknik, njësia e prokurimit vlerëson se, **operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë stafin kryesor teknik me kualifikimet dhe çertifikimet profesionale të kërkuara për realizimin e shërbimit objekt kontrate**. Kërkesa specifike për stafin/ inxhinierët e kërkuar është vendosur në përputhje me manualin e sipërcituar, në të cilin në gërmën D, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “*D.1.1 Përbërja e Ekipit të Punës, Secili nga ekipet e punës së terrenit duhet të përbëhet nga 2 specialistë profesionistë (inxhinjerë pyjesh) dhe 1 specialist teknik pyjesh (ekspert në punën e terrenit). Kjo është përbërja minimale e 1 ekipit që do punojë në terren... Kordinimi i aktiviteteve është një nga detyrat që duhet të kryejë Drejtuesi i Punës në Terren.*”. Ndërsa kërkesa për disponimin si pjesë të stafit kryesor dhe të 1 (një) inxhinieri *Topograf/Gjeodet/Markshajder*, është vendosur bazuar në analizën e procesit të shërbimit që do të kryhet për hartimin e planit të mbarështimit, ku ky inxhinier kryen një rol kryesor si: *kryerjen e matjeve në terren, përgaditjen e hartave, ndarjen e ngastrave, përpunimin dhe hedhjen e të dhënave etj.*, ku për vërtetimin e disponimit të tij, krahas dokumentacionit të kërkuar për të gjithë inxhinierët, duhet të paraqesin dhe liçencën në fushën e projektiveve nga organet kompetente në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 759, datë 12.11.2014 “*Për liçencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrjnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim*” (i ndryshuar).
3. Gjithashtu, në lidhje me kërkesën për paraqitjen e deklaratës së disponueshmërisë për stafin kryesor të angazhuar, kjo kërkesë është e bazuar në përcaktimet e **nenit 41, pika 4, gërma “d”** dhe **nenit 54** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*” (i ndryshuar), ku nëpërmjet paraqitjes së saj, operatorët

ekonomik pjesëmarrës dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen.

Stafi kryesor teknik (inxhinierët) i kualifikuar i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, duhet që nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar për t'u paraqitur, të vërtetojnë se disponojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.6 Operatori Ekonomik ose bashkimi i Operatorëve Ekonomike duhet të paraqesin **Planin e punës, përqasjen teknike dhe Metodologjinë** për Hartimin e Planit të Mbareshtimit (për Ekonomin/të Pyjore të ofertuar) i cili duhet të jetë në përputhje me termat e referencës dhe Udhezuesin e integruar në fuqi për Hartimin e Planeve të Menaxhimit, kuadri logjik ku argumentohen objektivat, aktivitetet, aktorët, rezultatet e pritëshme dhe indikatorët për realizimin me sukses të Planit të Mbarështimit. Subjekti mund të paraqese dhe justifikojë ndonjë modifikim e përmirësim të Termave të Referencës duke përmirësuar performancën e kryerjes së shërbimit (*Këto sygjerime duhet të jenë konçize dhe me hollesi dhe mund të përfshihen në propozim*).

Plani i Punës. *Në të duhet të propozohen aktivitetet kryesore për kryerjen e shërbimit, përmbajtjen e tyre dhe kohëzgjatjen, shkalla dhe raportet, kohëzgjatjen (duke përfshirë periudhën kohore të miratimit nga autoriteti i ngarkuar me ligj), dhe datat e dorëzimit të raporteve. Plani i punës së propozuar duhet të jetë konsistent me përqasjen teknike dhe metodologjinë, të tregojë mirëkuptimin e Termave të Referencës dhe aftësinë e përkthimit të tyre në një plan pune të realizueshëm. Duhet të përfshihen këtu, një listë me dokumentat përfundimtar, duke përfshire këtu edhe raportet, skicimet, dhe tabelat për tu paraqitur si outputet përfundimtare.*

Metodologjia dhe Perqasja Teknike. *Subjekti duhet të shpjegojë si i kupton ai objektivat e realizimit të këtij shërbimi, përqasja me shërbimet, metodologjinë për kryerjen e aktiviteteve dhe arritjen e outputeve të pritshme dhe shkallën e detajuar të këtyre outputeve. Duhet të theksojë problemet që do të adresohen dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përqasjen teknike që do të adaptojnë për ti adresuar ato. Gjithashtu duhet të shpjegojë metodologjinë që propozon të adaptojë dhe të theksojë përputhshmërinë e këtyre metodologjive me perqasjet e propozuara.*

Kërkesa e mësipërme do të plotësohet nga operatorët ekonomikë të kualifikuar gjatë fazës së parë dhe të përcaktuar në listën e shkurtër, e cila do të shërbejë gjatë fazës së dytë në vlerësimin e propozimeve teknike të dorëzuara.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 54, pika 11, gërma “ç”** e Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, dhe do të shërbejë gjatë fazës së dytë në vlerësimin e propozimeve teknike të dorëzuara nga operatorët ekonomikë të përcaktuar në listën e shkurtër.

Në rastet e bashkimit të konsulentëve, kriteret e veçanta të kualifikimit plotësohen bashkarisht nga i gjithë bashkimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Bazuar në shkresën **Nr.Prot.5662/1, datë 25.10.2023** dërguar nga Komisioni për Përcaktimin e Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike/ Bashkia Mat, ku bashkëlidhur ka dërguar specifikimet teknike/Termat e Referencës të shërbimit objekt prokurimi, duke qënë se ato plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të ligjit **nr.162/2020, datë 23.12.2020** “Për Prokurimin publik¹”, nenin 41 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave **Nr. 285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), dhe janë mbështetur *Manualin e Planeve të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit*, njësia e prokurimit kreu miratimin e specifikimeve teknike/Termave të Referencës për shërbimin objekt prokurimi.

- **Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.**
- **Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.**
- **Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë data 03.01.2024, ora 10.⁰⁰, vendi: në mënyrë elektronike në www.app.gov.al .**

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT